

**MARRËVESHJE TRANSFERIMI TË PJESËVE TË KAPITALIT  
TË SHOQËRISË “D&E” SH.P.K.**

Në Tiranë, sot më 12/10/2023, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

**Shitësi:**

- **Z. Ismail Kadiu**, shtetas shqiptar, lindur më 26/03/1961, në Vlorë, mbajtës i Dokumentit të Identifikimit me Nr. Personal G10326159K madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

*(më poshtë referuar “SHITËSI”)*

**Blerësi:**

- **Z. Dario Kadiu**, shtetas shqiptar, lindur më 01/05/1992, në Vlorë, mbajtës i Dokumentit të Identifikimit me Nr. Personal J20501088N madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

*(më poshtë referuar “BLERËSI”)*

**MEQËNËSE:**

- A. Shitësi zotëron 100% të Kapitalit të Shoqërisë “**D&E**” **Sh.p.k.**, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT K71804001C, me seli në: Rruga “Abdi Bej Toptani”, Godinë me Nr. Pasurie 41/89, Kati 1, Zona Kadastrale 2066; Valias, Kamëz, Tiranë, (“Shoqëria”), me një kapital prej 30.000.000 (*tridhjetë milion*) Lek, i përbërë nga 100 kuota.
- B. Blerësi dëshiron të blejë 100 % te Kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi në shoqërinë e lartpermendur “**D&E**” **Sh.p.k** siç përcaktohet në këtë marrëveshje.
- C. Në përputhje me **Ligjin Nr. 9901**, datë 14.04.2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar dhe nenet e Statutit të Shoqërisë, Ortaku i vetëm i shoqërisë **Z. Ismail Kadiu** ka marrë vendimin përkatës për transferimin tek Blerësi **Z. Dario Kadiu** të kapitalit si më sipër.

PËR SA ME SIPËR, palët bien dakort si më poshtë:

1. Shitësi pranon se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën nominale të kuotës, prej 30.000.000 (*tridhjetë milion*) Lek dhe për këtë arsye transferon ketu 100% të Kapitalit të zotëruar nga Shitësi **Z. Ismail Kadiu** tek Blerësi **Z. Dario Kadiu**.


Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se 100% e kuotave të kapitalit që transferohet këtu është në pronësinë e tij të plotë ligjore dhe të lirë nga barra, hipoteke apo pengje.

2. Blerësi pranon pronësinë e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bien dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
3. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, ortakë të shoqërisë dhe pjesët e kapitalit të zoteruara prej tyre në shoqërinë **“D&E” Sh.p.k.** do të jenë:
  - **Z. Dario Kadiu**, zotërues i 1 (një) kuote me 100% të kapitalit, me vlerë 30.000.000 (tridhjetë milion) Lekë të kapitalit të shoqërisë, me 1 (një) pjesë me vlerë 30.000.000 (tridhjetë milion) Lekë.
4. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kuotës objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Marrëveshje u hartua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore.

Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”*, i ndryshuar.

Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

SHITËSI  
ISMAIL KADIU  


BLERËSI  
DARIO KADIU  
